

të tepruara në portfolet tuaja.

- * Kartat e kreditit të sipërpërmendura janë ndërkombëtare. Ju mund të tërhiqni para cash nga çdo ATM e çfarëdo banke në Shqipëri dhe jashtë saj.
- * Mund të bëni blerje në internet.
- * Në vend që të jepni të holla në dyqane për të blerë, do të jepni kartën tuaj. Përdoren për të blerë mallra dhe për të përfituar shërbime, në Shqipëri dhe në botë.

PENALIZIMET

- * Kujdesuni që totali i shumës së faturuar të jetë paguar brenda afatit të caktuar.
- * Nëse ju nuk planifikoni të paguani plotësisht çdo muaj, duhet të informoheni në lidhje me interesin që do t'ju ngarkohet.
- * Vini re se kartat e kreditit kanë përqindje interesi të ndryshme për sasi parash të ndryshme. Në rast mospagese, banka mund të bllokojë kartën tuaj të kreditit dhe gjithashtu, të aplikojë interesin e saj të caktuar me bazë ditore, mbi shumën e vonuar.

BANKA E SHQIPËRISË

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:
www.bankofalbania.org

Nëse dëshironi të keni kopje të shkruara të tij mund t'i kërkonit në adresën:

Banka e Shqipërisë
Sheshi "Skënderbej" Nr.1 Tiranë Shqipëri,
Tel.: +355-(0)4-222152;
Faks: +355-(0)4-223558

ose duke dërguar një e-mail në adresën:
public@bankofalbania.org
Tirazhi: 1000 kopje



Kartat e Kreditit



ÇFARË JANË KARTAT E KREDITIT?

Përdorimi i kartave të kreditit për blerje të ndryshme është tashmë një fakt në jetën e konsumatorëve. Shumë njerëz sot kanë të paktën një kartë krediti ose më shumë.

Karta e parë e kreditit është hedhur në treg nga Diners Club dhe American Express në vitin 1951, e cila mund të përdorej në 27 restorante të New York-ut. Por vetëm në vitin 1970 pas daljes së shiritit magnetik, të cilin ajo përmban, u bë popullore.

Këto karta janë krijuar, që të zëvendësojnë paratë fizike (monedhë, kartëmonedhë) dhe t'ju lehtësojnë pagesat për blerjet dhe shërbimet. Kështu, nëse nuk keni me vete të holla, mund të blini atë që dëshironi, duke paguar lehtë dhe shpejt me kartën tuaj. Për këtë qëllim, ju vjen në ndihmë komoditeti i krijuar nga banka që ka lëshuar kartën me anë të instalimit të terminaleve POS dhe sporteleve ATM.

POS ose të quajtura ndryshe dhe pikat e shitjes, gjenden tashmë të instaluara në dyqane, hotele, restorante, agjenci udhëtimi, klinika mjekësore, supermarketet etj..

ATM-të ose Sportelet Automatike gjenden pranë filialeve të bankave dhe ju mundësojnë tërheqjen *cash* dhe kontrollin e gjendjes së llogarisë tuaj 24 orë në ditë, çdo ditë.

Një kartë krediti është një kartë magnetike që të lejon, nëpërmjet një kodi personal sekret (PIN), tërheqjen e *cash*-it, nxjerrjen e gjendjes së llogarisë dhe nxjerrjen e lëvizjeve të llogarisë pranë sporteleve automatike. Ajo përmban: logon e bankës që e ka lëshuar; një element sigurie të paraqitur në formën e një chip-i 3 me 5 mm; një numër të dukshëm që është dhe numri i identifikimit të bankës; kohën e skadimit (muajin dhe vitin); një numër ekstra dhe një kod sigurie treshifror (jo të gjitha kartat e kanë këtë kod sigurie).

Kartat e kreditit mund të merren pranë bankave tregtare që zhvillojnë aktivitetin në Shqipëri. Ato mund t'ju dërgohen edhe në shtëpi, për të lehtësuar aplikimin tuaj.

LLOJET E KARTAVE.

Kartat e kreditit që tashmë janë të pranishme në Shqipëri janë disa llojesh. Kështu ju mund të pajiseni me kartën Mastercard, Visa, American Express, Diners.

Kartat e kreditit kanë filluar të përdoren në Shqipëri që prej vitit 1999.

ÇFARË INFORMACIONI DUHET TË DINI PARA SE TË APLIKONI PËR T'U PAJISUR ME NJË KARTË KREDITI.

Në qoftë se dëshironi një kartë, banka tregtare mund t'ju japë informacionin e duhur ose t'ju tregojë se si mund ta merrni informacionin e mëposhtëm:

- * Të kesh një llogari bankare. Si mund të hapni një llogari bankare dhe minimumin e parave që duhet të keni për të hapur atë.
- * Kufirin maksimal të shpenzimit të parave për blerjet që mund të kryeni.
- * Sasinë e parave që mund të përdorni për çdo pagesë të kryer. Sa është kufiri për sa i përket tërheqjes *cash*?
- * Sa janë penalitetet për pagesat e vonuara ose tejkallim të kufirit të kredisë.
- * Shumën e interesave vjetorë që do t'ju aplikohen.
- * Si llogaritet ky interes vjetor.
- * Datën kur ju duhet të kryeni pagesën e kartës së kreditit.

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSONI PËR TË PËRFITUAR NJË KARTË KREDITI.

Për t'ju pajisur me një kartë ju mund të shkoni pranë çdo banke tregtare, fillimisht duhet të hapni një llogari bankare, duke paraqitur një dokument identifikimi dhe një vërtetim individual për të ardhurat mujore.

Çdo muaj vjen në adresën e përcaktuar nga ju, një pasqyrë e të gjitha veprimeve që keni kryer me kartën tuaj.

Çdo muaj paguhet pjesa e shpenzuar nga ju për muajin paraardhës ose mund të paguhet e gjithë fatura. Kjo pagesë mund të kryhet duke derdhur shumën në bankë ose banka i tërheq automatikisht nga llogaria që ju tashmë keni hapur tek ajo.

AVANTAZHET DHE PËRFITIMET.

- * Krijojnë siguri më të madhe se sa mbajtja *cash*. Karta ju ndihmon të shmangni mbajtjen e shumave